



Republika e Kosovës
Komuna e Mitrovicës së Jugut



Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
30.05.2022

Raport nga Tubimi me Publikun për Plotësim Ndryshimin e Rregullorës Komunale për Mbeturina, Rregullorja Nr. 03/2016 për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Rregullore 05/2019 për plotësim/ ndryshim të Rregullorës 03/2016 për menaxhimin e mbeturinave

Hyrje

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neni 9 pika 2, Komuna e Mitrovicës, harton Raport të Tubimit të Parë me Publikun i cili është mbajtur me datën 27.05.2022, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 14:00.

Ecuria e procesit të takimit

Për këtë tubim, Komuna ka bërë me kohë lajmërimin dhe ka publikuar njoftimin në ueb faqe të Komunës, në dy gjuhët zyrtare, dy javë para mbajtjes, <https://konsultimet.rks.gov.net/viewMeeting.php?MeetingID=48>, në rrjetet social të Komunës (Facebook, Instagram), njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të Komunës, në "TV Mitrovica", si dhe në mediat online.

Pas hartimit të këtij raporti dhe dhënies së protokollit të brendshëm, i njëjti do t'i dërgohet të gjitha drejtorive dhe njësive komunale.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë pune	17
2. Publikimi në ëeb faqe	14 ditë pune	17

Në këtë tubim publik kanë marrë pjesë 17 pjesëmarrës, prej tyre 6 femra dhe 11 meshkuj. Tubimi me publikun ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e Komunës njoftojnë për aktivitetet komunale të parapara më këtë Rregullore Komunale për Mbeturina, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe objektivat në të ardhmen, ndërsa të pranishmit mund të bëjnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me tarifrat dhe objektivat të planifikuara si dhe për çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Për të elaboruar aktivitetet e Komunës, për planet dhe sfidat, fjala kryesore i takoj Komisionit Komunal për Hartimin e kësaj Rregullore.

Mbledhjen e hapi kryetari i Komisionit, Irfan Peci, ndërsa të pranishëm ishin: Anëtarët e komisionit, administrator të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve, përfaqësues të bizneseve, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë.

Kryetari i Komisionit Irfan Peci, fillimisht ka përshëndetur të pranishmit duke theksuar se është mirënjohës ndaj të gjithë qytetarëve për pjesëmarrjen në këtë proces. Ai më tutje ka shtuar se së bashku me ekipin e tij me vendosmëri dhe përgjegjësi institucionale do t'i përfaqësoj rekomandimet e qytetarëve në këtë rregullore.

Të pranishmit në takim, kanë shtruar komente, pyetje dhe rekomandime për këtë rregullore. Po ashtu nga ana e qytetarëve janë parashtruar pyetje dhe janë adresuar kërkesa të cilat kryesisht kishin të bënin për lehtësimin dhe përmirësimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së Deponisë.

Ndërsa të gjitha pyetjeve dhe kërkesave të qytetarëve ju është përgjigjur, Komisioni i emruar.

Kërkesat e qytetarëve të parashtruara gjatë këtij tubimi ishin:

Shtojca – tabela e detajuar me informatat për kontribuesit, arsyetimet për përgjigjet e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet/ komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Tubimi me Publikun Plotësim Ndryshimin e Rregullorës Komunale për Mbeturina	Fshati Koprivë ka probleme lidhur me kundërmimin e deponisë së Mbeturinave në Germovë. Të mirëmbahët me shumë Deponia dhe të caktohet tarifa për deponinë e mbeturinave në Germovë. Po ashtu ti ndalohët Komunave regjionale ti deponojnë mbeturinat në këtë deponi.	Xhelazim Baliu nga fshati Koprivë	Kërkesat e adresuara në lidhje me mirëmbajtjen e deponisë së Mbeturinave në Germovë	Pjesërisht, Kërkesat duhet të inkorporohen në Rregullorën Komunale
Tubimi me Publikun për Plotësim Ndryshimin e Rregullorës Komunale për Mbeturina	Fshati Koprivë ka probleme lidhur me kundërmimin e deponisë së Mbeturinave në Germovë. Kanali i Ujit i Ibër Lepencit i cili kalon afër deponisë të mirëmbahet. Të mirëmbahët me shumë Deponia dhe të caktohet tarifa për deponinë e mbeturinave në Germovë. Po ashtu ti ndalohët Komunave regjionale ti deponojnë mbeturinat në këtë deponi.	Haxhi Salihu- Fshati Koshtovë	Kërkesat e adresuara në lidhje me mirëmbajtjen e deponisë së Mbeturinave në Germovë	Pjesërisht, Kërkesat duhet të inkorporohen në Rregullorën Komunale, pasi që disa kalojnë kompetencat e komunës së Mitrovicës
Tubimi me Publikun për Plotësim Ndryshimin e Rregullorës	Në rregulloren e ekzistuese shitoret e këpucëve kanë qenë të diskriminuara pasi që kanë qenë në Nënkatëgorin 2 me 10.80 €/muaj, gjersa Dyqanet e tekstilit kanë qenë në Nënkatëgorin 1	Hasdin Tahiri – përfaqësues i bizneseve të tipit	Kërkesat e adresuara në lidhje me taksën për bizneset	Plotësisht janë aprovuar kërkesat e kësaj kategorie biznesi.

Komunale për Mbeturina	me 6.00 €/muaj, edhe pse gjenerojnë njëjtë mbeturina.	Shitore të këpucve		
Tubimi me Publikun për Plotësim Ndryshimin e Rregullorës Komunale për Mbeturina	Vendosja e kontenjerve në rrugë, problem për komunikacionin	Artan Ibishi, Inxhinier I Komunikacionit	Vendosja e kontenjerve në hapësira të duhura	Pjesërrisht, Kjo rregullore nuk i cakton lokacionet për kontenjer, por kriteret e vendosjes janë të qelluara.

30.05.2022



Kryetari i Komisionit


Irfan Peci



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DISKUTIM PUBLIK

Draft- Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Mitrovicës së Jugut

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Data: 27.05.2022

Ora: 14:00

LISTA E PJESËMARRËSVE

Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nr. Telefonit	Nënshkrimi
1	Fatmir Kelmendi	Mitrovica		
2	Levdian Hyçeni	Mitrovicë		
3	Hasan Bani	KORINE		
4	HAXHI SALIPI	KOSHTOVË		
5	HADIN TAHIRI	VINARCI EPËRM		
6	ISMET TAHIRI	MITROVICË		
7	Ibrahim Delija	Mitrovicë		
8	FILLOJETA JAKU UKA	MITROVICË		
9	AGRON SYLJEMANI	MITROVICË		
10	ARTAN IBISHI	MITROVICË		
11	VLORA BEJTA	MITROVICË		
12	BURKIME VUKANI	MITROVICË		
13	IRFAH PEÇI	MITROVICË		
14	Behri Sinani	Mitrovicë		
15	Ermeta Gashi	Mitrovicë		
16	VIOLETA FITAKU	MITROVICË		
17	Tajeta Selmani Pllana	Vushtrri		
18	Blerynd Kostrehi	Mitrovicë		
19				
20				
21				
22				